REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 689/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 689/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "Limit L&B" SH.P.K. - Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i parqeve rekreative sportive në Bllacë dhe Komunë" me nr. të prokurimit: 624-20-066-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Suharekë, më datë: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Limit L&B" SH.P.K. – Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i parqeve rekreative sportive në Bllacë dhe Komunë" me nr. të prokurimit: 624-20-066-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Suharekë.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i parqeve rekreative sportive në Bllacë dhe Komunë" me nr. të prokurimit: 624-20-066-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Suharekë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet t'a informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Limit L&B" SH.P.K. - Prizren , aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Limit L&B" SH.P.K. - Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.09.2020 me nr. 689/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i parqeve rekreative sportive në Bllacë dhe Komunë" me nr. të prokurimit: 624-20-066-521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Suharekë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 06.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Konstatimi për pretendimin 1 ankimorë që është shkelur neni 7 nga AK i Komunës së Suharekës, eksperti shqyrtues mendon se është pjesërisht i qëndrueshëm pasi të dy kompanitë kanë mangësi në plotësimin e kritereve të dosjes së tenderit, mirëpo tek kompania e rekomanduar për kontratë ka pasur tolerime tek njëri kriter, ndërsa tek kompania ankuese nuk ka pasur tolerim te kriteri tjetër.

Kriteret që nuk i kanë plotësuar as kompania e rekomanduar për kontratë, e as Ankuesja është pasi kërkesa 4 e kërkuar OE të jetë i pajisur me Certifikatë IAAF (International Association of Athletics Federations) në këtë rast OE nuk pajisen me certifikatë IAAF, por IAAF-ja ju lëshon OE certifikatë si ISO apo të ngjashme që punët sportive duhet të kryhen sipas Standardeve IAAF, në këtë rast as kompania ankuese por as e rekomanduar nuk kanë certifikatë të lëshuar nga IAAF.

Konstatimi për Pretendim 2 OE ankues- se konzerciumi i OE të rekomanduar për kontratë kamionët i ka me afate të skaduar të regjistrimit, eksperti duke u bazuar në dokumente të ofertës pretendimi i OE Ankues qëndron pasi pajisjet tjera që janë të blera nga kompania Drita ka mungesë të dëshmisë që ka blerë apo marrë me qira.

Grupi i OE ka disa marrëveshje tjera lidhur me pajisjet, por nuk janë te lidhura në mes Liderit dhe OE që i ka marrë me qira por në mes partnereve që janë pjesë e konzorciumit.

Pretendimi Ankimor i OE Ankues se nuk ka pajisjet e kërkuar dhe me Afat të skaduar, eksperti mendon se duhet të konsiderohet si devijim i vogël në përputhje me nenin 59 të LPP-se për të dy kompanitë, pasi te dy kompanitë edhe Ankuesja por edhe rekomanduesja kanë mangësi – mos plotësim të dëshmive përcjellëse të pajisjeve. Gjithashtu eksperti mendon nëse AK dëshiron të vazhdoj me këtë tender duhet të ju kërkoj dokumente - dëshmitë origjinale që kanë dorëzuar në ofertë në përputhje me nenin72 për pajisjet që ka kërkuar në Dosjen e Tenderit, në mënyrë që të nxjerrë ofertën më të mirë.

Konstatimi Pretendimi 3 - Sa i përket referencave që OE Ankues nuk ka kontrata apo referenca për punët te ngjashëm si Arsye për Eliminim të këtij OE nga AK i Komunës se Suharekës nuk qëndron. Pretendimi Ankimor i OE në këtë pikë është pjesërisht i bazuar, mirëpo AK i Komunës së Suharekës është dashur t'a vërtetoj kontratën në mes OE Ankues dhe kompanisë Lake Side AG SH.P.K. që ka dorëzuar me ofertë a është kryer kjo punë me dëshmi përkatës si pagesa dhe me dëshmi tjera që është realizuar puna, e atëherë pas vërtetimit të kësaj reference AK mundet të jep si arsye për eliminim të këtij OE ankues.

Eksperti mendon se Arsyet e eliminimit të OE ankues nuk munden të jenë të qëndrueshme pa u vërtetuar kontrata që ka dorëzuar së bashku me ofertën e OE Ankues Limit L&B SH.P.K. në njërën anë dhe kompanisë Lake Side AH SH.P.K., pra kjo referencë duhet të vërtetohet me nenin 72 të LPP-së.

Konstatimi Pretendimi 4 - Në kërkesën për stafin është kërkuar që t'i ketë tre vite provojë pune por te dëshmia nuk e kanë cekur se me çfarë duhet të dëshmojë përvojën, por vetëm kanë kërkuar Diploma të noterizuara, CV, Dëshmitë që është i/e punësuar të OE, ose marrëveshjet për këtë Projekt. Në këtë rast, Valmir Bytyqi e ka një kontratë mbi vepër me kompaninë "N.N.T. VEHA" me emër të projektit, mirëpo nuk ka dëshmi që tregon përvojën tre vjeçare por edhe AK i Komunës se Suharekës nuk ka cekur në dosjen e tenderit e as në Njoftimin për Kontratë se çfarë duhet të dëshmojë përvojën me CV, me kontrata të punës apo me ATK kriteri i vlerësimit është konfuz..

Në bazë të kësaj, eksperti konstaton se pretendimi ankimor i OE është pjesërisht i bazuar për Ekologun Bytyqi, por duke u bazuar se AK nuk ka bërë specifikim të dëshmisë së qartë, atëherë të kërkohet në bazë të nenit 72 provoja e punës 3 vite për projekte te ngjashëm para publikimit të njoftimit të kontratës, nëse AK dëshiron të vazhdoj me këtë Aktivitet te Prokurimit.

Konstatimi Pretendimi 5 se kompania Limit L&B SH.P.K. është me çmim më të ulët dhe duhet të jemi të rekomanduar për kontratë, ky pretendim sipas ekspertit është pjesërisht i qëndrueshëm pasi oferta e tij është me çmim më të ulët, por nuk është plotësisht i përgjegjshëm, por AK i Komunës së Suharekës duhet t'i vërtetojë dokumentacionin sipas nenit 72 të cekur më lartë.

Gjithashtu në kërkesën për rishqyrtim që kam analizuar unë si ekspert, AK i Komunës së Suharekës nuk ka rishqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues ka pasur mundësi AK t'i korrigjoj lëshimet qe janë bërë gjatë

fazës së vlerësimit.

Duke u bazuar në të gjeturat e Dosjes së Tenderit dhe në njoftimin për kontratë, AK i Komunës së Suharekës ka mangësi në përshkrim të kritereve të vlerësimit, si për shembull shtrohet pyetja se a ka qenë i nevojshëm kriteri i kërkuar Kërkesa 4 - OE të jetë i pajisur me Certifikatë IAAF (International Association of Athletics Federations). Gjithashtu të gjeturat tjera të cekura më lartë të lidhur me referencat, pajisjet dhe stafin të vërtetohen në përputhje me dosjen e tenderit dhe sipas konstatimeve që unë si ekspert i kam cekur në paragrafët më lartë. Atëherë unë si ekspert mendoj që tenderi me titull: "Rregullimi i parqeve rekreative sportive në Bllacë dhe Komunë" të anulohet vendimi mbi dhënien e lënda të kthehet në Rivlerësim dhe ankesa të merret si pjesërisht e bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues duke sqaruar:
Eksperti nuk ka marrë parasysh dokumentet e dorëzuara në ofertën e OE të propozuar për fitues, ngase në dokumentet përkatëse shihet qartë dhe nuk ka qenë e nevojshme të kërkohen sqarime shtesë. Andaj kërkoj nga Paneli Shqyrtues që konform shkresave të dorëzuara në ofertë të refuzojë ankesën e OE "Limit L& B" dhe të vërtetojë njoftimin për dhënie të AK. Kjo kërkesë vije pasi shihet qartë se OE ankues nuk plotëson kërkesat e AK të kërkuara në dosjen e tenderit.

Operatori Ekonomik, me datë: 09.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për shkelje te nenit 7 te LPP-së nga AK.
Paneli shqyrtues konstaton se tek NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE ose PERMIRESIM I GABIMIT AK ka kërkuar : Kërkesa 4- OE të jetë i pajisur me Certifikatë IAAF (International Association of Athletics Federations). Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se eksperti shqyrtues profesional ka konstatuar se të dy kompanitë kanë mangësi në plotësimin e kritereve të dosjes së tenderit. Kriteret që nuk i kanë plotësuar as kompania e rekomanduar për kontratë, e as Ankuesi, dhe sipas ekspertit në këtë rast OE-të nuk pajisen me certifikatë IAAF, por IAAF-ja ju lëshon OE certifikatë si ISO apo të ngjashme që punët sportive duhet të kryhen sipas Standardeve IAAF. Andaj Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK duhet ti trajtoj në pajtim me nenin 7 te gjithë operatoret e ekonomik pjesëmarrës lidhur me kriterin e cekur si më lart.

Lidhur me pretendimin e OE ankues- se konzerciumi i OE të rekomanduar për kontratë kamionët i ka me afate të skaduar të regjistrimit, Paneli shqyrtues konsideron se kjo mund te konsiderohet si devijim i vogël në pajtim me nenin 59.4 të LPP-së nga se sipas ligjit në fuqi për qarkullim rrugor automjet nuk guxojnë te dalin ne rruge pa u regjistruar, pavarësisht kësaj me rastin e rivlerësimit për çfarëdo paqartësie AK mund te kërkoj sqarime për te sqaruar mëdyshjet qe ka në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se pajisjet tjera që janë të blera nga kompania Drita OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka mungesë të dëshmisë që ka blerë apo marrë me qira.
Paneli shqyrtues konstaton se te NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE ose PERMIRESIM I GABIMIT, AK Ka kërkuar : Kërkesa3 - Pajisjet e nevojshme me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Ekskavator, minimumi 2 deri 3.5 ton, Një(1) Ekskavator , 5 deri 7 tone, Një(1) Ekskavator mbi 18 Tone dy(2) Kamionë të rënde, Një(1) Kamion 6 deri 6.5tone, një (1) Ngjeshës Cilindër një (1) Damper , Një (1) Ngarkues 4.5-5 tone dhe një(1) Grejder Rrafshues.,
Si dëshmi është kërkuar : Kërkesa3 - Pajisjet e nevojshme me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Ekskavator, minimumi 2 deri 3.5 ton, Një(1) Ekskavator , 5 deri 7 tone, Një(1) Ekskavator mbi 18 Tone dy(2) Kamionë të rënde, Një(1) Kamion 6 deri 6.5tone, një (1) Ngjeshës Cilindër një (1) Damper , Një (1) Ngarkues 4.5-5 tone dhe një (1) Grejder Rrafshues.

3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzim të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marruar me qira si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Doganor); DESHMI: 3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Doganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzim të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marruar me qira si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Doganor)

Paneli shqyrtues konfom ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Grupi i OE ka disa marrëveshje lidhur me pajisjet, te lidhura në mes te partnereve që janë pjesë e konzorciumit dhe operatoreve tjerë, mirëpo për çfarëdo paqartësi lidhur me pretendimin në fjalë AK mund te kërkoj sqarime në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk qëndron arsyeja e eliminimit e dhen nga AK për ankuesin se nuk ka kontrata apo referenca për punët te ngjashëm. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se me rastin e rivlerësimit AK Komuna e Suharekës duhet t'a vërtetoj kontratën në mes OE Ankues dhe kompanisë Lake Side AG SH.P.K. që ka dorëzuar me ofertë, a është kryer kjo punë me dëshmi përkatës si pagesa dhe me dëshmi tjera që është realizuar puna.

Pra paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se AK duhet ta vërtetoj kontratën që ka dorëzuar së bashku me ofertën e OE Ankues Limit L&B SH.P.K. në njërën anë dhe kompanisë Lake Side AH SH.P.K., pra kjo referencë duhet të vërtetohet me nenin 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së për përvojën e pune për Ekologun Bytyqi. Paneli shqyrtues sqaron se AK në DT ka specifikuar OE po ashtu duhet të ketë se paku një Bachelor te Ekologjisë dhe mbrojtje te mjedisit se paku 3 vjet pune pas diplomimit- Diploma të noterizuara, CV, Dëshmitë që është i/e punësuar të OE, ose marrëveshjet për këtë Projekt

Paneli shqyrtues sqaron se për kërkesën e cekur si me lart OE i rekomanduar pre kontratës për ekologun Valmir Bytyqi ka paraqitur këto dëshmi : diplomën, CV dhe një kontratë mbi vepër me kompaninë "N.N.T. VEHA" me emër të projektit. Diploma tregon se personi në fjale ka diplomuar me 13.03.2012, ndërsa CV-ja tregon se i njëjti person ka punuar në KK Suhareke nga data :15.02.2015, deri me 15-05.2015,në Shkollën e

mesme profesionale nga data 18.05.2015-30.11.2015 dhe nga data 01.10.2011-11.03.2015-hulumtues i Makrobentosit –Specie Endemike .

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se në kërkesën për stafin është kërkuar që t'i ketë tre vite provojë pune por te dëshmia AK nuk e kanë cekur se me çfarë duhet të dëshmojë përvojën, por vetëm kanë kërkuar Diploma të noterizuara, CV, Dëshmitë që është i/e punësuar të OE, ose marrëveshjet për këtë Projekt. Në këtë rast, ekologu ka ofruar dëshmitë e lartcekura , por duke u bazuar se AK nuk ka bërë specifikim të dëshmisë së qartë, dhe ekologu ne fjale ka një paqartësi rreth përvojës se tij te pune te përshkruar në CV konstatojmë se me rastin e Rivlerësimit AK duhet të kërkoj sqarime në bazë të nenit 72 të LPP-se dhe nenit 39.8 te RRUOPP dhe te vërtetohet se OE në fjalë a plotëson kërkesën e AK-së, për përvojën e punës siç është kërkuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se kompania Limit L&B SH.P.K. është me çmim më të ulët dhe duhet të jemi të rekomanduar për kontratë.
Paneli shqyrtues konstaton se kriteri i çmimit është vetëm njeri nga kriteret për vlerësim, e që plotësimi i vetëm këtij kriteri nuk e përcakton fituesin e kontratës sepse për tu konsideruar i përgjegjshëm dhe për tu rekomanduar për dhënie te kontratës OE duhet te plotësoj edhe kërkesat-kriteret tjera te vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate, andaj me rastin e rivlerësimit AK është e obliguar që vlerësimin e ofertave te bej në pajtim me nenin 7 ,59 dhe 60 te LPP-së dhe për kontrate te rekomandohet veten ai operator ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka qenë me çmim më të ulet.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Suharekë

1x1 OE -"Limit L&B" SH.P.K. - Prizren

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.